



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 3615 Prot.

Kuçovë, më 16. 10. 2019

**RAPORT PËRMBLEDHËS I DËGJESËS PUBLIKE MBI SISTEMIN E PIKËZIMIT
PËR BANESAT SOCIALE**

Më datë 16.10.2019, ora 13⁰⁰, në sallën e Këshillit Bashkiak u organizua dëgjesa publike, lidhur me sistemin e pikëzimit për programet e banesave sociale me qira.

Dëgjesa u hap nga Nënkyetarja e Bashkisë Znj. Miranda Shkëmbi dhe njëkohësisht Kryetarja e Komisionit të Strehimit, e cila zhvilloi një diskutim mbi programet e strehimit social, si dhe theksoi vlerën e rëndësishme që kanë konsultimet publike në lidhje me vendimarrjen.

Ajo pasqyroi punën e Komisionit të strehimit, i cili ka respektuar të gjitha afatet ligjore si dhe hapat e ndërmarra nga përgatitja e sistemit të pikëzimit dhe organizimin e kësaj dëgjese publike. Në fjalën e saj nënkryetarja e Bashkisë citoi se ky proces do të jetë transparent dhe të gjitha materialet, vendimarrjet e Komisionit të Strehimit, do të publikohen në mjediset përkatëse të Bashkisë Kuçovë si dhe në faqen ëeb të Bashkisë Kuçovë.

Mbas fjalës hyrëse të Nënkyetares së Bashkisë, vijoi prezantimi i sistemit të pikëzimit për programin e banesave sociale, prezantimi i cili u ndal në disa pika kryesore:

Kuadri ligjor, fazat në të cilat ka kaluar projekti i ndërtimit të banesave sociale, ku u përmend se numri i apartamenteve është 12, i strukturave 1+1 dhe 2+1.

Projekti ka filluar në vitin 2014 ku nga ana e Bashkisë Kuçovë është aplikuar në M.Zh.U (sot, Ministri e Financave dhe Ekonomisë), nga korrespondencat e mbajtura, është theksuar se ky financim është kërkuar për të strehuar banuesit në ish pronë private.

Prezantimi u ndal me gjatë në sistemin e pikëzimit ku nga relatuesit u shpjeguan rubrikat përbërëse të sistemit të pikëzimit si dhe shpërndarja e pikës përkatëse.

Ku u theksua se sistemi i pikëzimit përbën instrumentin kryesor të adresimit të nevojave të aplikantëve si dhe krijon një renditje të familjeve aplikuese.

Mbas përfundimit të prezantimit Kryetarja e Komisionit, u ndal të theksoi se këto apartamente janë regjistruar në emër të Bashkisë Kuçovë, si dhe sistemimi i banorëve do të bëhet me anë të kontratës së qiradhënies, masa e qirasë do t'i propozohet Këshillit Bashkiak për miratim.

Në vijim u diskutua edhe lista e dokumentacioneve që duhet të dorëzojnë aplikantët për të përfituar strehimin social.

Pas prezantimeve të bëra nga anëtarët e komisionit, diskutimi vijoi me pyetje nga të pranishmit.

Pyetjet e para u bënë nga banuesit në ish pronë private, përkatësisht Klodian Laze, Artan Shehu, Shaban Çela, Alime Pire, Saimir Toska të cilët kërkuan, që në këto apartamente, të strehohen familjet të cilat janë detyruar të lirojnë banesat në zbatim të aktit normativ të kthimit të banesave ish pronarëve si dhe kërkuan që këto banesa, të mos jepen me qira por t'u falen aplikantëve.

Në përgjigje të këtyre pyetjeve, përfaqësues të Komisionit të Strehimit sqaruan se:

Panvarësisht se financimi i projektit përkoi me kohën që këto familje kanë liruar banesat, këto apartamente kanë statusin e banesave sociale me qira për këtë arsye të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha familjet në nevojë, si dhe ligji i strehimit social parashikon se banesat sociale shpërndahen sipas kontratave të qirasë dhe pronësia e tyre nuk ndryshon.

Në vijim diskutuan edhe Dituri Kaloti, si dhe Hajrie Brahimaj të cilat paraqitën gjendjen e tyre social – ekonomike, si dhe kërkuan të bëhen pjesë e proçesit të vlerësimit.










Në përgjigje u bë me dije, se pas publikimit të listës së dokumentacioneve që duhet të paraqesë familjet për t'u trajtuar me strehim, ato si dhe gjithë aplikantët do t' i nënshtrohen sistemit të pikëzimit dhe nëse do marri pikët e mjaftueshme do të përfitojnë strehim.

Diskutuan edhe disa familje, mes të cilave Arta Hetemaj të cilat dispononin banesë por kërkonin rikonstrukcion e tyre.

Në përgjigje u bë me dije se, në rast thirrje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për fonde mbi rikonstrukcionin e banesave, Komisioni i Strehimit do të shqyrtoi të gjitha kërkesat për këto raste, me qëllim hartimin e projekteve përkatëse për t'u aplikuar.

Në përfundim të Dëgjësës Publike, Znj. Miranda Shkëmbi, ftoi të gjithë të pranishmit të paraqesin propozime me shkrim, vërejtje, sygjerime apo ndryshime të mundshme lidhur me këtë sistem pikëzimi, në mënyrë që të përfshihen në dokument, para se të kalojnë për miratim në Këshillin Bashkiak.

Komisioni i Strehimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr. 3632 Prot.

Kuçovë, më 17.10. 2019

PROCSVERBALI I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË STREHIMIT

Datë 17/10/2019

I mbajtur sot me date 17 Tetor 2019, ne mjediset e zyres se NenKryetarit te Bashkise Kuçovë në prani te perfaqesueseve te Komisionit te Strehimit, mbi raportin e degjeses publike organizuar me date 16/10/2019 mbi sistemin e pikezimit per programet e strehimit social. Komisioni diskutoi per:

- 1) Propozim për sistemin e pikëzimit sipas programeve të strehimit social.
- 2) Dokumentacionet të cilat duhet të dorëzojë aplikantet për të përfiturar strehim social.
- 3) Propozim mbi mënyrën e llogaritjes së qirasë për banesat sociale.
- 4) Mbi raportin e dëgjësës publike të dates 16.10. 2019

Ne perfundim: Sistemi pikezimit i cili do i propozohet Këshillit Bashkiak do të jetë si më poshtë

- 1) Kushtet e strehimit – 30 pike
a-12p pike, b- 6 pike, c-5 pike, ç-4 pike, d-3 pike
- 2) Kushtet familjare- 20 pike
a-5pike, b-7 pike, c-3 pike, ç-5 pike
- 3) Kushtet sociale- 20 pike.
a-5 pike, b-5 pike, c-2 pike, ç-4 pike, d-4pike.
- 4) Kushtet ekonomike- 30 pike
a-15 pike, b-10 pike, c-5 pike.

Pjesë e dokumentacionit që do i përcillet Këshillit Bashkiak do të jetë dhe lista e dokumentave që duhet të dorezojnë aplikantet dhe mënyra e llogaritjes së qerasë së banesës sociale.

Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgoje propozimet pranë
Këshillit të Bashkisë Kuçovë për miratim.

Komisioni i Strehimit

Ferdinand Rutoz
Heroin Shkëmbi
Miranda Shkëmbi
Bledar Gjermani
Valmir Basmazani
Majlinda Mimani
Arwindu Bardhi
Hertgem Bullari
Sami Veliu

KRYETARI I KOMISIONIT
Miranda SHKËMBI

